



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1001/12 Prot.

Tiranë, më 28/04 /2022

VENDIM

Nr. 09, datë 28.04. 2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”, NË INXHINIERI MEKANIKE DHE MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE NË “STUDIMI I VETIVE ELEKTRIKE TË FIBRAVE TEKSTILE DHE NDIKIMI I TYRE NË PROCESET E PËRPUNIMIT” DHE “STUDIM MBI VLERËSIMIN NUMERIK TË EMETIMEVE NDOTËSE NGA MOTORËT ME DJEGIE TË BRENDSHME. RAST NË STUDIM: SITUATA NË SHQIPËRI, VLERËSIME DHE REKOMANDIME PËR ARRITJEN E TARGETEVE TË VITIT 2030 NË PËRPTHJE ME: PLANI KOMBËTAR PËR ENERGJINË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE 2021-2030”, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE, NË UPT**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.04.2022,

VENDOSI:

**Miratimin e propozimit për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Mekanike dhe miratimin e projekteve kërkimore-shkencore në “Studimi i vetive elektrike të fibrave tekstile dhe ndikimi i tyre në proceset e përpunimit” dhe “Studim mbi vlerësimin numerik të emetimeve ndotëse nga motorët me djegie të brendshme. Rast në studim: Situata në Shqipëri, vlerësime dhe rekomandime për arritjen e targeteve të vitit 2030 në përputhje me: Plani kombëtar për energjinë dhe ndryshimet klimatike 2021-2030”, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në Universitetin Politeknik të Tiranës.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

